

SISTEMIMI NË SHKOLLË PËRKUJDESJA E FËMIJËVE PRINDËRIT U NDIHMOJNË FËMIJËVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



HYRJE

Zgjedhja e përkujdesjes për fëmijën tuaj mund të jetë e vështirë – çdo ditë ka më shumë zgjedhje, por megjithatë mund të jetë e vështirë që ta gjeni përkujdesjen me të cilën jeni të lumtur ju dhe fëmija juaj, që mund ta paguani me buxhetin që keni, dhe që punon brenda orarit që ju përshtatet.

KËSHILLAT KRYESORE

- Kontaktoni me Shërbimin tuaj lokal të Informacionit për Fëmijë [Children's Information Service] për t'u informuar se çfarë ofrohet në zonën tuaj.
- Para se të vendosni përfundimisht, merreni fëmijën tuaj dhe vizitoni së bashku ata përkujdesës që i keni përzgjedhur në rrethin e ngushtë.
- Kërkoni nga ata që t'ju tregojnë certifikatën e regjistrimit OfSTED (Zyra për Standarde në Shkollim - *Office for Standards in Education*) si dhe raportin e fundit të inspektimit.
- Shikojani letërdhëzimet (vlen për kujdestarët dhe për dadot)
- Shikoni se çfarë lehtësimesh financiare ofrohen, si për shembull neni i përkujdesjes së fëmijëve në kuadër të Kredisë së Tatimit të Punës [Working Tax Credit]

ÇFARË DËSHIRONI?

Shumë prindër të punësuar bazohen në ndihmën e familjeve të veta – por jo çdokush ka familjarë në afërsi, e ka të tillë që parapëlqejnë zgjedhje tjetër. Mundësitë e përkujdesjes së fëmijëve përfshijnë kujdestarët (zakonisht për fëmijët e moshës 0-7 vjeçe), çerdhet e fëmijëve (për moshën 0-4 vjeçe), klubet para- dhe passhkollore, projektet e lojës gjatë pushimeve dhe dadot.

SI TË VENDOSNI?

- Le të vendosë cilësia!
- Çdo përkujdesje për fëmijët nën moshën 8 vjeçe – përjashtuar dadot – duhet të jetë e regjistruar nga OfSTED, nëse është e hapur për më shumë se 2 orë në ditë
- Të gjithë duhet që t'ju tregojnë raportin e fundit të inspektimit nga OfSTED – i cili do t'ju shërbejë si dëshmi për cilësinë e përkujdesjes së ofruar për fëmijë dhe të shkollimit të hershëm.
- Cili është orari i punës dhe sa të larta janë shpenzimet?
- Cilat janë më afër jush/rrugës për në punë?

Shërbimi i Informacionit për Fëmijë

Çdo zonë e ka Shërbimin e vet të Informacionit për Fëmijë [Children's Information Service]. Aty mund t'ju informojnë se ku janë kujdestarët më të afërt, çerdhet dhe projektet jashtëshkollore, përfshirë orarin e tyre të punës dhe pagesat javore. Telefoni kujdestar 08000 96 02 96 do t'ju lidhë me shërbimin tuaj më të afërm të informacionit për fëmijë. Gjithashtu, mund të vizitoni adresën www.childcarelink.gov.uk

Doni kujdestarë?

- Kujdestarët punojnë në shtëpinë e tyre dhe zakonisht përkujdesen për fëmijët parashkollorë ose për ata të moshës së shkollës. Në të shumtën e rasteve, ata/o janë të gatshëm/me që t'i çojnë fëmijët në shkollat që gjenden në afërsi dhe t'i marrin përsëri pas mbarimit të orëve të mësimi.
- Nëse është e nevojshme, kujdestarëve mund t'iu lejohet që të punojnë në shtëpinë tuaj nëpërmjet sistemit vullnetar të aprovimit të përkujdesjes për fëmijë [Childcare Approval Scheme].
- Tarifat ndryshojnë, por mesatarja në Angli kap shumën e 130 funtave në javë¹
- Kërkoni prej tyre që t'ju tregojnë certifikatën e regjistrimit dhe raportin e fundit të inspektimit.

Jashtë shkollës?

- Shumë shkolla ofrojnë klube para fillimit të mësimi/klube të mëngjesit (të hapura prej orës 8-9 të mëngjesit) – për mesatarisht 1-2 funta në ditë.
- Aktivitetet dhe klubet pas mësimi (të cilat shpesh janë të hapura deri në orën 6 pasdite) – për mesatarisht 40 funta në javë.
- Projektet e lojës gjatë ditëve të pushimit (të hapura prej orës 8 paradite deri në orën 6 në mbrëmje gjatë ditëve të pushimit shkollor) – për 50-100 funta në javë ose më shumë.
- Nëse shkolla vetë nuk ofron përkujdesje, ajo mund t'ju drejtojë te qendra më e afërt e përkujdesjes më e afërt.

Doni dado?

- Dadot përkujdesen për fëmijët në shtëpinë tuaj.
- Nuk kanë nevojë që të posedojnë kualifikim për përkujdesje të fëmijëve.
- Nuk kanë nevojë që të jenë të regjistruara nga OfSTED – edhe pse mund të jenë të regjistruara nëpërmjet sistemit vullnetar të aprovimit të përkujdesjes për fëmijë [Childcare Approval Scheme].
- Mund të kushtojnë prej 150-400 funta në javë.

NDIHMJA PËR SHPENZIMET

Shpenzimet e përkujdesjes cilësore për fëmijë mund të jenë të larta, por në disa raste mund të merrni ndihmë financiare: nëse jeni student, nga punëdhënësi juaj, ose nëpërmjet nenit të përkujdesjes së fëmijëve në kuadër të Kredisë së Tatimit të Punës:

- Në vlerë prej maksimalisht 80% të pagesave deri në 175 funta në javë për një fëmijë (300 funta për dy ose më shumë fëmijë) për përkujdesje të regjistruar ose të aprovuar.
- Për prindërit që punojnë 16 orë ose më shumë në javë e që kanë të drejtë (te familjet me dy prindër duhet të punojnë që të dy) - Telefononi numrin 0845 300 3900 për t'u informuar nëse ju takojnë ndihmat (varësisht nga të ardhurat shtëpiake) ose vizitoni www.hmrc.gov.uk/taxcredits.

RRITJA E PËRZGJEDHJES

- Një qendër për fëmijë në çdo lagje deri në vitin 2010.
- Mundësia e përkujdesjes për fëmijë nga ora 8 paradite deri në orën 6 pasdite gjatë gjithë vitit për të gjitha shkollat fillore deri në vitin 2010.

¹ Sipas studimit Daycare Trust Survey, 2006

- Shfrytëzoheni Shërbimin tuaj lokal të Informacionit për Fëmijë për të gjetur zgjedhjen më të mirë për vete.

Për informata dhe këshilla të mëtejme:

Kërkoni përkujdesje për fëmijë? Fletushka orientuese *Një fillim i sigurt* [A Sure Start] (28fq) mund të porositet falas me telefon në numrin 0845 60 222 60 ose mund të shkarkohet nga website-i i Sure Start www.surestart.gov.uk (në 14 gjuhë të ndryshme).

Ju lutemi shënojini në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.